

ethet hemorragjike vazhdon të paktën deri më 15 qershor. Zogaj ka thënë se ka një ngrijje të vetëdijesimit të qytetarëve të

se kjo është preventiva më e mirë nga infeksioni pasi nëse rriqra mënjanohet nga trupi në 3 orët e para personi nuk infektohet", nëpër të gjitha shkollat e

jekt 20 mijë euro, ndërkohë që edhe Ministria e Shëndetësisë ka ndarë një fond prej 20 mijë eurosh.

Shoqëria civile në Lipjan publikoi raportin për punën e legjislativit

YAHR: Legjislativi i Lipjanit vazhdon shkelejen e Statutit komunal

Sipas raportit të organizatës së të rinjve YAHR, Kuvendi i Lipjanit është duke vazhduar me shkelje të Statutit komunal që nga mbledhja e dytë e mbajtur në shkurt 2010, pasi që atëkohë drejtoritë ishin rritur për tri më shumë sesa parasheh Statuti

KOHA
SHKURT

ARIAN DURIQI

LIPJAN, 1 QERSHOR – Mungesa e harmonizimit të drejtorive komunale me aktin më të lartë komunal që prej një viti e gjysmë ka bërë që kjo shkelje të jetë sërisht nën llupën e shoqërisë civile në Lipjan, më konkretisht në raportin e fundit të publikuar nga organizata e të rinjve YAHR.

"Kuvendi i Lipjanit është duke vazhduar punimet me shkelje të Statutit komunal që nga mbledhja e dytë e mbajtur në shkurt 2010, me rastin e miratimit të emërimeve të drejtorëve të propozuar nga kreu komunal, Shukri Bujaj. Aty është shkëlur nëni 47 i Statutit të Kuvendit të Komunës të miratuar më 26 shtator 2009, ku parasihen 10 drejtori, ndërsa janë emëruar 13 drejtorë në po aq drejtori", ka thënë Bekim Krasniqi, udhëheqës i YAHR-it. Për më tepër, ai vë në pah se ka

pasur përpjekje nga ana e legjislativit për harmonizimin e Statutit me gjendjen faktike në seancën e gjashtë të korrikut 2010, por që kjo përpjekje ka dështuar në mungesë të 2/3 të votave të këshilltarëve të KK-së. Po kështu, shoqëria civile, ndërkaq, nuk është aspak e kënaqur as me opozitën në Kuvendin e Lipjanit, derisa vë në pah mosefikasitet të tyre.

"Kemi konstatuar se në mbledhjet e KK-së te një pjesë e madhe e opozitës mungon efikasiteti në artikulimin e interesave të qytetarëve, për çka edhe janë zgjedhur. Është për t'u habitur fakti se, edhe pse shoqëria civile i drejtohet opozitës për përkrahje dhe zgjidhje të problemeve, ata prapëseprapë janë të heshtur", ka thënë Krasniqi, derisa ka kërkuar opozitë më të zëshme në artikulim interesash të qytetarëve të kësaj

Redaksia

e gazetës

KOHA
DITORE

SHIPALL

KONKURS

Për korrespondentë nga Peja e Shtimja

Kandidatët duhet të dorëzojnë: CV, dëshmi të përvojës së tyre, letër motivimi, si edhe referenca eventuale.

Dokumentet duhet të dorëzohen në adresën elektronike

redaksia@kohaditore.com dhe koha_ditore@hotmail.com

Ftohen për intervistë vetëm kandidatët e përzgjedhur.

Konkursi mbetet i hapur deri më 2 qershor 2011



Sipas YAHR-it, ndonëse me nenin 47 të Statutit të Kuvendit të Komunës parasihen 10 drejtori, KK i Lipjanit ka formuar 13 sosh

komune. Në këtë plan, YAHR, ka konstatuar po ashtu se gjatë tetë seancave sa janë mbajtur deri tashti në KK në këtë mandat, nuk ka pasur asnjëherë iricim të çështjeve urgjente dhe kërkesa për interpelancë të ekzekutivit të Komunës nga ana e deputetëve të KK-së.

Ndërkohë që, Sefer Tasholli, këshilltar nga LDK-ja, ka deklaruar se KK-ja po vepron

jashtëligjshëm që prej kohës kur janë rritur drejtoritë komunale. "Me gjithë kundërshtimet që kemi bërë se rritja e drejtorive nuk ka qenë e ligjshme dhe në kundërshtim me aktin më të lartë komunal, kjo situatë nuk është ndryshuar, pos që ka pasur përpjekje për ta ndryshuar Statutin komunal dhe për ta harmonizuar me situatën aktuale, për çka ne prapë kemi qenë kundër", ka thënë ai.